

## ANEKSI 8

### Për menaxhimin e mbetjeve urbane në njësitë e vetëqeverisjes vendore

1. Fondet shtesë për menaxhimin e mbetjeve urbane akordohen si transfertë e pakushtëzuar sektoriale sipas tabelës nr.3 “Transferta e pakushtëzuar për bashkitë për vitin 2024”. Këto fonde janë një mekanizëm financiar shtesë që mbështet bashkitë për mirëmenaxhimin e mbetjeve urbane.
2. Detajimi i këtyre fondeve në tabelën nr. 3 “Transferta e pakushtëzuar për bashkitë për vitin 2024”, sipas bashkive është bërë duke marrë parasysh: a) sasinë e mbetjeve vjetore dhe b) kostot shtesë për transportin e tyre në pikat fundore të grumbullimit dhe përpunimit.
3. Detajimi i fondeve është bërë për bashkitë:
  - a) Malësi e Madhe, Shkodër, Vau i Dejës, Pukë, Fushë Arrëz, Lezhë dhe Kurbin për financimin e transportit të mbetjeve urbane në zonën e menaxhimit të mbetjeve Shkodër.
  - b) Krujë, Durrës, Vorë, Kamëz, Shijak, dhe Kavajë për financimin e transportit të mbetjeve urbane në zonën e menaxhimit të mbetjeve Tiranë.
  - c) Librazhd, Elbasan, Rrogozhinë, Peqin, Cërrik, Belsh, Prrenjas dhe Gramsh, për financimin e transportit të mbetjeve urbane në zonën e menaxhimit të mbetjeve Elbasan.
  - d) Himarë, Sarandë, Gjirokastrë, Tepelenë, Memaliaj, Këlcyrë, Përmet, Libohovë dhe Dropull, për financimin e transportit të mbetjeve urbane në zonën e menaxhimit të mbetjeve Gjirokastrë.
4. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit i dërgon bashkive kuadrin ligjor, nënligjor, standardet dhe të dhëna të tjera që disponon të cilat janë të lidhura me menaxhimin e mbetjeve urbane. Njësitë e vetëqeverisjes vendore shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për transportimin e mbetjeve urbane në zonat e menaxhimit të mbetjeve.
5. Gjatë vitit 2024, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe shoqatën/përfaqësuesit e bashkive përgatit një metodologji për menaxhimin e mbetjeve urbane dhe vendos tregues performance për bashkitë në funksion të rritjes së cilësisë së mirëmenaxhimit të mbetjeve urbane.
6. Kjo mbështetje buxhetore e cila synon mirëmenaxhimin e mbetjeve urbane duhet të bëhet pjesë e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 dhe në vijim e qeverisjes qendrore dhe asaj vendore. Kjo mbështetje duhet të bëhet pjesë e raportit të monitorimit të zbatimit të buxhetit të bashkive.
7. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë monitoron periodikisht përdorimin e fondit shtesë për menaxhimin e mbetjeve urbane sipas bashkive përfituese.